



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____.____.2026

**PËR
RREGULLAT DHE PROCEDURAT E MONITORIMIT TË SITUATËS SË FËMIJËS TË
VENDOSUR NË KUJDES ALTERNATIV NË FAMILJE, SI DHE PËR ORGANIZIMIN DHE
ZBATIMIN E MONITORIMIT DHE INSPEKTIMIT TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 24, pika 7, dhe nenit 25, pika 4, të ligjit nr. 92/2025 "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet sociale, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

1. Ky vendim përcakton rregullat dhe procedurat për monitorimin e situatës së fëmijës të vendosur në kujdes alternativ në familje, si dhe për organizimin dhe zbatimin e monitorimit dhe inspektimit të zbatimit të standardeve dhe procedurave të kujdesit alternativ në familje
2. Vendimi përcakton përgjegjësitë e strukturave vendore dhe qendrore, mënyrën e koordinimit ndër-institucional, dokumentimin, raportimin, trajtimin e gjetjeve dhe përdorimin e instrumenteve standard të monitorimit dhe inspektimit.

**Neni 2
Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij vendimi është garantimi i interesit më të lartë të fëmijës, sigurisë, mirëqenies dhe zhvillimit të tij gjatë vendosjes në kujdes alternativ në familje, si dhe sigurimi i cilësisë, ligjshmërisë, transparencës dhe llogaridhënies në ofrimin e këtij shërbimi.
2. Monitorimi dhe inspektimi synojnë identifikimin në kohë të nevojave, rreziqeve, mangësive ose shkeljeve, përcaktimin e masave mbështetëse dhe korrigjuese, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit.

Neni 3

Parimet e monitorimit dhe inspektimit

Monitorimi dhe inspektimi zhvillohen në përputhje me këto parime:

- a) interesi më i lartë i fëmijës si konsideratë parësore në çdo veprim dhe vendimmarrje;
- b) respektimi i dinjitetit, të drejtave dhe nevojave individuale të fëmijës;
- c) pjesëmarrja dhe dëgjimi i fëmijës, në përputhje me moshën, pjekurinë dhe nivelin e zhvillimit të tij;
- ç) vlerësimi i bazuar në evidencë, dokumentacion dhe të dhëna të verifikueshme;
- d) proporcionaliteti, objektiviteti;
- dh) transparencja, llogaridhënia dhe gjurmueshmëria e veprimeve;
- e) konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale;
- ë) bashkëpunimi ndërinstytucional dhe koordinimi efektiv ndërmjet strukturave përgjegjëse.

Neni 4

Instrumentet standarde

1. Monitorimi i situatës së fëmijës në familje kujdestare dhe ofrimi i shërbimit realizohet në përputhje me metodologjinë e monitorimit, e cila hartohet dhe miratohet nga Shërbimi Social Shtetëror.
2. Inspektimi i ofrimit të shërbimit kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin duke përdorur instrumentet standarde.
3. Instrumentet standarde të monitorimit dhe inspektimit përfshijnë:
 - a) formularin e monitorimit të situatës së fëmijës dhe familjes kujdestare;
 - b) formularin e monitorimit të ofruesit të shërbimit;
 - c) formularin e raportit të inspektimit të shërbimit;
 - ç) planin e masave korigjuese dhe formularin e verifikimit të zbatimit të masave.
4. Çdo informacion i mbledhur nëpërmjet instrumenteve standarde, dokumentohet në dosjen e rastit dhe/ose në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje, kur ky regjistër është funksional, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU II

ORGANIZIMI DHE ZBATIMI I MONITORIMIT

STRUKTURAT PËRGJEGJËSE DHE KOORDINIMI

Neni 5

Nivelet e monitorimit

1. Monitorimi realizohet në nivel vendor, rajonal dhe qendror, sipas përgjegjësive të përcaktuara në këtë vendim dhe në legjislacionin në fuqi.
2. Në nivel vendor, monitorimi kryhet nga Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës, Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit dhe struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki.
3. Në nivel rajonal dhe qendror, Shërbimi Social Shtetëror monitoron zbatimin e standardeve të shërbimit, mbështet strukturat vendore metodologjike dhe evidenton problematikat sistematike.



4. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale ushtron rolin e drejtimit politik dhe mbikëqyrës, përmes miratimit të udhëzimeve mbi procesin e monitorimit dhe standardeve të shërbimit.

Neni 6

Përgjegjësitë e strukturave vendore

1. Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës/Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës është përgjegjës/e për monitorimin e drejtpërdrejtë të situatës së fëmijës, përfshirë vizitat në familjen kujdestare, takimet me fëmijën, familjen biologjike/aktuale, vlerësimin e nevojave, dokumentimin e gjetjeve dhe propozimin e masave të nevojshme.
2. Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit shqyrton ecurinë e rastit, vlerëson përmbushjen e nevojave të fëmijës, fuqizimin e familjes biologjike kur kjo është e parashikuar, dhe, kur është e nevojshme, rekomandon rishikimin e planit individual, ndryshimin e masave mbrojtëse ose referimin pranë strukturave të tjera kompetente.
3. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki siguron organizimin institucional të monitorimit, administron raportet, ndjek zbatimin e masave korrigjuese dhe koordinon bashkëpunimin ndërmjet strukturave vendore.
4. Në rastet kur shërbimi i kujdesit alternativ në familje ofrohet me mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë me përvojë në fushën e mbrojtjes së fëmijës dhe shërbimeve shoqërore, këto subjekte bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse dhe vendosin në dispozicion informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e monitorimit, në përputhje me legjislacionin dhe marrëveshjes përkatëse.

Neni 7

Përgjegjësitë e Shërbimit Social Shtetëror

1. Shërbimi Social Shtetëror /Drejtoritë Rajonale, përmes strukturave të posaçme monitoron zbatimin e standardeve të shërbimit në nivel rajonal dhe/ose qendror, nëpërmjet vizitave periodike, verifikimeve të bazuara në risk, analizës së të dhënave dhe shqyrtimit të raporteve të strukturave vendore.
2. Shërbimi Social Shtetëror / Drejtoritë Rajonale kryen vizita monitoruese jo më rrallë se një herë në gjashtë muaj për rastet dhe/ose ofruesit e përzgjedhur, si dhe më shpesh kur evidentohen ankesa, sinjalizime, risk i lartë ose problematika sistematike.
3. Shërbimi Social Shtetëror përgatit raporte periodike dhe rekomandime për përmirësimin e praktikave, standardeve dhe kapaciteteve të strukturave përgjegjëse.

Neni 8

Përgjegjësitë e ofruesit të shërbimit të kujdestarisë familjare

1. Familjet që ofrojnë shërbimin e kujdesit alternativ në familje mbajnë dokumentacion të plotë dhe të përditësuar për çdo rast, raportojnë çdo muaj pranë strukturës përgjegjëse vendore dhe njoftojnë menjëherë çdo rast, dyshim për abuzim, neglizhencë, shfrytëzim, dhunë ose rrethanë tjetër që mund të cenojë fëmijën, si dhe çdo ndryshim të rrethanave që mund të ndikojë në sigurinë, mirëqenien ose zhvillimin e fëmijës.
2. Familjet që ofrojnë shërbimin e kujdesit alternativ në familje bashkëpunojnë me strukturat monitoruese dhe inspektuese, japin informacion të plotë e të saktë, mundësojnë aksesin në

dokumentacion dhe zbatojnë masat e përcaktuara përgajtë proceseve të monitorimit dhe inspektimit.

Neni 9 Koordinimi ndërinstucional

1. Strukturat përgjegjëse bashkëpunojnë ndërmjet tyre për shkëmbimin e informacionit, harmonizimin e praktikave, ndjekjen e masave dhe trajtimin e problematikave që lidhen me fëmijën, familjen kujdestare ose ofrimin e shërbimit.
2. Shkëmbimi i informacionit kryhet vetëm për qëllime të menaxhimit, monitorimit, inspektimit ose mbrojtjes së rastit dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Koordinimi ndërmjet Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Shërbimit Social Shtetëror, njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe strukturave të mbrojtjes së fëmijës siguron analizën e të dhënave, mbështetjen metodologjike, identifikimin e problematikave sistemike dhe përmirësimin e shërbimit.

KREU III MONITORIMI I SITUATËS SË FËMIJËS, FAMILJES KUJDESTARE

Neni 10 Monitorimi

1. Për çdo fëmijë të vendosur në kujdes alternativ në familje hartohet dhe zbatohet plani individual kujdesi, pjesë përbërëse e të cilit është edhe plani individual i monitorimit.
2. Planin individual i monitorimit përmban objektivat e monitorimit, nevojat prioritare të fëmijës, elementet që do të vlerësohen, periodicitetin e vizitave dhe takimeve, përgjegjësit për zbatimin, si dhe masat që ndërmerren në rast evidentimi të riskut ose mospërbushjeje të nevojave.
3. Planin rishikohet sa herë ndryshojnë rrethanat e fëmijës, familjes kujdestare ose ofrimit të shërbimit, dhe jo më rrallë se një herë në 3(tre) muaj.

Neni 11 Periodiciteti i monitorimit

1. Monitorimi i situatës së fëmijës kryhet në mënyrë të planifikuar dhe periodike, si dhe në mënyrë të menjëhershme kur lind nevoja.
2. Gjatë 3 (tre) muajve të parë nga vendosja e fëmijës në kujdes alternativ në familje, monitorimi në mjedisin familjar kryhet jo më pak se një herë në 2(dy) javë.
3. Pas përfundimit të periudhës së parashikuar në pikën 2 të këtij neni, monitorimi kryhet jo më pak se 1 (një) herë në muaj, ose më shpesh në varësi të vlerësimit të nevojave dhe nivelit të riskut.
4. Rishikimi periodik i përgjithshëm i situatës së fëmijës kryhet brenda 6 (gjashtë) javëve nga vendosja dhe, më pas, jo më rrallë se një herë në 3(tre) muaj.
5. Pavarësisht periodicitetit të përcaktuar në këtë nen, monitorimi kryhet menjëherë kur raportohen ose evidentohen rrethana që mund të cenojnë sigurinë, mirëqenien ose zhvillimin e fëmijës.

Neni 12 Metodologjia e monitorimit

1. Monitorimi i situatës së fëmijës realizohet përmes vizitave në familjen, ku është vendosur fëmija, takimeve individuale me fëmijën, takimeve me familjen kujdestare, familjen biologjike ose personat e tjerë të rëndësishëm për fëmijën, komunikimit me institucionet arsimore, shëndetësore dhe struktura të tjera të përfshira, si dhe verifikimit të dokumentacionit të rastit.
2. Në rast nevojë, monitorimi mund të realizohet në bashkëpunim me profesionistë të ndryshëm multidisiplinarë, sipas natyrës së problematikës së evidentuar.
3. Vizitat monitoruese mund të jenë të njoftuara ose të panjoftuara, në varësi të qëllimit të monitorimit, nivelit të riskut dhe nevojës për verifikim objektiv të rrethanave.
4. Gjatë monitorimit sigurohet, kur është e mundur dhe e përshtatshme, zhvillimi i bisedës me fëmijën në mënyrë të veçantë, në kushte që garantojnë privatësi, besueshmëri dhe liri shprehjeje.
5. Çdo vizitë monitoruese shoqërohet me dokumentim të gjetjeve, rekomandimeve dhe veprimeve të nevojshme për ndjekjen e rastit. Nëse gjatë një monitorimi ndërmerren veprime emergjente, ato dokumentohen menjëherë dhe pasqyrohen në dosjen e rastit dhe/ose në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.
6. Informacioni i mbledhur duhet të jetë i saktë, i plotë, i verifikueshëm, i përditësuar dhe i integruar me të dhënat e strukturave të tjera përgjegjëse.

Neni 13

Elementet e monitorimit të situatës së fëmijës

Gjatë monitorimit të situatës së fëmijës vlerësohen, të paktën:

- a) siguria fizike dhe emocionale e fëmijës;
- b) marrëdhënia e fëmijës me familjen kujdestare dhe me anëtarët e tjerë të mjedisit familjar;
- c) gjendja shëndetësore, psikologjike dhe emocionale e fëmijës;
- ç) vijimësia dhe ecuria në arsim, zhvillim dhe socializim;
- d) respektimi i të drejtave të fëmijës, përfshirë të drejtën për t'u dëgjuar;
- d) ruajtja e marrëdhënieve me familjen biologjike ose persona të tjerë të rëndësishëm për fëmijën, kur kjo është në interesin e tij;
- e) përshtatshmëria dhe stabiliteti i vendosjes;
- ë) zbatimi i planit individual dhe i masave të përcaktuara në dokumentacionin e rastit;
- f) çdo rrethanë që mund të ndikojë në sigurinë, mirëqenien, zhvillimin ose të drejtat e fëmijës.
- g) evidentimi i shenjave të neglizhencës, dhunës, abuzimit ose riskut;
- gj) dokumentimi i çdo shqetësimi dhe ndjekja e masave korrigjuese;
- h) përfshirja e mekanizmave të referimit emergjent;
- i) ruajtja e konfidencialitetit dhe mbrojtja e të dhënave personale;
- j) koordinimi ndërinstitutional;
- k) marrja në konsideratë e mendimit të fëmijës

Neni 14

Pjesëmarrja e fëmijës

1. Fëmija informohet, në mënyrë të kuptueshme dhe në përputhje me moshën dhe nivelin e zhvillimit, për qëllimin e monitorimit dhe për të drejtën e tij për të shprehur mendimin.
2. Mendimi i fëmijës dëgjohet, merret në konsideratë dhe dokumentohet në çdo rast, në përputhje me moshën, pjekurinë dhe gjendjen e tij.
3. Mospjesëmarrja ose pamundësia e fëmijës për të shprehur mendimin, nuk pengon zhvillimin e monitorimit. Arsytet e mospjesëmarrjes së fëmijës përgjatë procesit pasqyrohen në dokumentacionin e rastit.

Neni 15
Monitorimi i familjes kujdestare

1. Familja kujdestare monitorohet periodikisht për të vlerësuar aftësinë, qëndrueshmërinë dhe përshtatshmërinë e saj për të përmbushur nevojat e fëmijës.
2. Gjatë monitorimit të familjes kujdestare vlerësohen kushtet e jetesës dhe siguria e mjedisit familjar, marrëdhënia e fëmijës me kujdestarët, aftësia e familjes për të përmbushur nevojat fizike, emocionale, arsimore, shëndetësore dhe sociale të fëmijës, bashkëpunimi me strukturat përgjegjëse dhe nevoja për mbështetje shtesë. Gjatë procesit të monitorimit vlerësohet edhe kapaciteti i familjes kujdestare për vetëreflektim dhe përmirësim të vazhdueshëm të praktikave të kujdesit, si dhe gatishmëria e saj për të pranuar dhe zbatuar rekomandimet profesionale.
3. Kur evidentohen vështirësi në ushtrimin e kujdesit, struktura përgjegjëse përcakton masa mbështetëse për familjen kujdestare, përfshirë këshillim, orientim profesional, mbështetje psiko-sociale, trajnim ose referim pranë shërbimeve të tjera.
4. Kur familja kujdestare nuk bashkëpunon, nuk zbaton planin individual ose krijon rrethana që cenojnë interesin më të lartë të fëmijës, struktura përgjegjëse propozon rishikimin e vendosjes dhe ndërmarrjen e masave përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.
5. Shpeshhtësia e monitorimit përcaktohen në varësi të llojit të familjes kujdestare dhe nivelit të nevojës së fëmijës. Familjet kujdestare profesionale i nënshtrohen monitorimit më të shpeshtë dhe më të strukturuar, për shkak të natyrës së specializuar të kujdesit që ofrojnë.

Neni 16
Dokumentimi dhe raportimi i monitorimit

1. Çdo veprim monitorimi dokumentohet në formularët përkatës, sipas shtojcave bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Dokumentacioni i monitorimit përmban datën, vendin dhe formën e monitorimit, personat e përfshirë, burimet e informacionit, gjetjet, mendimin e fëmijës kur është marrë, problematikat e evidentuara, nivelin e riskut, masat e propozuara ose të ndërmarra, rekomadimet në vijim, afatet dhe përgjegjësit për ndjekjen e tyre.
3. Struktura përgjegjëse regjistron të dhënat pa vonesë pas çdo veprimi monitorues dhe, në çdo rast, jo më vonë se 5 ditë pune nga data e kryerjes së monitorimit, përveç rasteve emergjente, të cilat dokumentohen menjëherë.
4. Në përfundim të çdo monitorimi hartohet raporti përkatës, i cili administrohet në dosjen e rastit dhe regjistrohet në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje, kur ky regjistër është funksional.
5. Kur nga monitorimi rezulton nevoja për ndryshim të masave mbrojtëse, të planit individual ose të kushteve të vendosjes, struktura përgjegjëse ndërmerr pa vonesë procedurat për rishikimin e rastit.

KREU IV
KLASIFIKIMI I RISKUT dhe MASAT KORRIGJUESE

Neni 17
Klasifikimi i nivelit të riskut

1. Monitorimi i situatës së fëmijës dhe i shërbimit bazohet në vlerësimin e nivelit të riskut, me qëllim përcaktimin e shpeshhtësisë së monitorimit, llojit të ndërhyrjes dhe masave të nevojshme mbrojtëse ose korrigjuese.

2. Për qëllime të këtij vendimi, risku klasifikohet si i ulët, i mesëm, i lartë ose i menjëhershëm/emergjent, mbi bazën e instrumenteve standarde të vlerësimit të riskut.
3. Risku i ulët konstatohet kur situata e fëmijës është e qëndrueshme, nevojat bazë përmbushen dhe nuk evidentohen rrethana që cenojnë sigurinë, mirëqenien ose zhvillimin e fëmijës.
4. Risku i mesëm konstatohet kur evidentohen sjellje problematike apo vështirësi emocionale, vështirësi në përshtatje, në marrëdhëniet me familjen kujdestare, në ndjekjen e arsimit, në përmbushjen e nevojave psiko-sociale ose në zbatimin e planit individual, por pa rrezik të menjëhershëm për fëmijën.
5. Risku i lartë konstatohet kur evidentohen problematika serioze që mund të cenojnë sigurinë, mirëqenien, zhvillimin ose të drejtat e fëmijës, përfshirë konflikte të përsëritura, neglizhencë, mungesë bashkëpunimi, kur ka dyshim për dhunë apo abuzim, moszbatim të planit individual ose paqëndrueshmëri të vendosjes.
6. Risku i menjëhershëm/emergjent konstatohet kur ekzistojnë indicie ose rrethana që tregojnë rrezik të drejtpërdrejtë për jetën, shëndetin, sigurinë, integritetin fizik ose emocional të fëmijës
7. Niveli i riskut dokumentohet në dosjen e rastit dhe rishikohet sa herë ndryshojnë rrethanat e fëmijës, familjes kujdestare ose ofrimit të shërbimit.
8. Çdo ndryshim i nivelit të riskut shoqërohet me rishikimin e planit individual të kujdesit dhe të planit të monitorimit, si dhe me marrjen e masave të përshtatshme mbrojtëse, referuese ose korrigjuese, në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës.

Neni 18

Masat sipas nivelit të riskut

1. Në rastet me risk të ulët, monitorimi kryhet sipas periodicitetit të zakonshëm të përcaktuar në këtë vendim.
2. Në rastet me risk të mesëm, monitorimi intensifikohet dhe struktura përgjegjëse rishikon planin individual, duke përcaktuar masa shtesë mbështetëse për fëmijën dhe familjen kujdestare.
3. Në rastet me risk të lartë, struktura përgjegjëse thërret pa vonesë shqyrtimin e rastit nga strukturat kompetente, harton ose përditëson planin e masave dhe kryen monitorim të intensifikuar deri në stabilizimin e situatës.
4. Në rastet me risk të menjëhershëm ose emergjent, struktura përgjegjëse ndërhyr menjëherë, referon rastin sipas procedurave të mbrojtjes së fëmijës dhe ndërmerr masat e nevojshme për garantimin e sigurisë së fëmijës, pa pritur përfundimin e procedurave të zakonshme të monitorimit.

Neni 19

Shkalla e vlerësimit të përmbushjes së standardeve

1. Gjatë monitorimit ose inspektimit, përmbushja e standardeve vlerësohet në bazë të instrumenteve standarde dhe klasifikohet si: nuk përmbushet, përmbushet pjesërisht, përmbushet mjaftueshëm, përmbushet kryesisht ose përmbushet plotësisht. Për çdo standard që vlerësohet si “nuk përmbushet”, “përmbushet pjesërisht” ose “përmbushet mjaftueshëm”, struktura përgjegjëse përcakton masat korrigjuese, afatin, përgjegjësin dhe mënyrën e verifikimit.

Neni 20

Masat korrigjuese

1. Për çdo problematikë, mangësi ose shkelje të konstatuar gjatë monitorimit, struktura përgjegjëse përcakton masat korrigjuese, afatin për zbatimin e tyre, personin ose strukturën përgjegjëse dhe mënyrën e verifikimit të përmbushjes.
2. Masat korrigjuese klasifikohen si:
 - a. masa urgjente, kur problematika cenon ose mund të cenojë menjëherë jetën, shëndetin, sigurinë, mirëqenien ose zhvillimin e fëmijës; këto zbatohen menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 24 deri në 48 orë nga konstatimi;
 - b. masa afatshkurtra, kur problematika kërkon ndërhyrje të shpejtë për të parandaluar përkeqësimin e situatës; këto zbatohen jo më vonë se 15 ditë nga njoftimi;
 - c. masa të zakonshme korrigjuese, kur problematika lidhet me mangësi në dokumentim, organizim, bashkëpunim, ndjekje të planit individual ose përmbushje të standardeve; këto zbatohen jo më vonë se 30 ditë nga njoftimi;
 - ç. masa strukturore, kur problematika kërkon ndryshime organizative, rishikim procedurash, forcim kapacitetesh, sigurim burimesh ose trajnim të stafit; këto zbatohen brenda 60 deri në 90 ditëve, mbi bazën e një plani të miratuar masash.
3. Në rastet kur zbatimi i masave strukturore kërkon afat më të gjatë se 90 ditë, subjekti përgjegjës paraqet arsyetimin me shkrim dhe planin e detajuar të zbatimit, i cili miratohet nga struktura përgjegjëse.

Neni 21

Monitorimi i përsëritur dhe referimi në organe më të larta

1. Zbatimi i masave korrigjuese verifikohet përmes monitorimit të përsëritur, shqyrtimit të dokumentacionit, vizitës në terren ose çdo forme tjetër të përshtatshme verifikimi, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Në rast të moszbatimit të masave korrigjuese brenda afateve të përcaktuara, çështja i referohet strukturës përgjegjëse më të lartë për vlerësim të mëtejshëm dhe, sipas rastit, për kryerjen e monitorimit të përsëritur, inspektimit të paplanifikuar ose marrjen e masave administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Çdo referim dhe veprim i ndërmarrë dokumentohet dhe ndiqet deri në zgjidhjen e problematikës ose deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga organi kompetent.

KREU V

ORGANIZIMI DHE ZBATIMI I INSPEKTIMIT

Neni 22

Objekti i inspektimit

1. Inspektimi i shërbimit të kujdesit alternativ në familje kryhet për të verifikuar përputhshmërinë e ofrimit të shërbimit me kërkesat ligjore, standardet e miratuara, kushtet e certifikimit dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi.
2. Inspektimi i kujdesit alternativ në familje fokusohet në vlerësimin e mirëqenies, sigurisë dhe zhvillimit të fëmijës, zbatimin e planit individual të kujdesit, respektimin e kushteve të vendosjes dhe bashkëpunimin me strukturat përgjegjëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 23

Struktura përgjegjëse inspektuese

1. Inspektimi kryhet nga struktura inspektuese përgjegjëse për shërbimet sociale, në përputhje me legjislacionin për inspektimin dhe me ligjin për kujdesin alternativ në familje.
2. Personat e përfshirë në monitorim ose inspektim nuk mund të marrin pjesë në proces kur ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit ose kur ekzistojnë rrethana që cenojnë paanshmërinë e vlerësimit.

Neni 24 **Procedura e inspektimit**

1. Inspektimi i kujdesit alternativ në familje kryhet në format e mëposhtme:
 - a) inspektim i planifikuar;
 - b) inspektim i paplanifikuar;
 - c) inspektim tematik;
 - ç) inspektim i jashtëzakonshëm, në raste emergjente ose me kërkesë të organeve kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Inspektimi kryhet mbi bazën e planit vjetor të inspektimit, të miratuar nga struktura përgjegjëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe prioritetet për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës. Përzgjedhja e rasteve bazohet në analizën e riskut, të dhënat nga monitorimi, ankesat, sinjalizimet dhe informacionet e tjera të besueshme.
3. Gjatë inspektimit verifikohet përputhshmëria me legjislacionin, standardet e kujdesit alternativ në familje dhe zbatimi i planit individual të kujdesit, përmes shqyrtimit të dokumentacionit, vizitave në terren dhe intervistave me aktorët përkatës, në përputhje me parimet e mbrojtjes së fëmijës dhe legjislacionin për të dhënat personale.
4. Në përfundim të inspektimit hartohet raporti i inspektimit, i cili përmban gjetjet, vlerësimin e përputhshmërisë, rekomandimet dhe masat e propozuara, si dhe afatet për zbatimin e tyre.
5. Subjekti i përfshirë në kujdesin alternativ ka të drejtë të njihet me gjetjet dhe të paraqesë sqarime brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, përpara miratimit të aktit përfundimtar të inspektimit.
6. Zbatimi i masave të përcaktuara në aktin përfundimtar të inspektimit ndiqet nga struktura përgjegjëse dhe verifikohet përmes monitorimit ose inspektimit të mëtejshëm, sipas nevojës.

KREU VI **DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 25 **Shkëmbimi i informacionit**

1. Shkëmbimi i informacionit kryhet nëpërmjet kanaleve zyrtare dhe vetëm për qëllime të përcaktuara nga ky vendim dhe legjislacioni në fuqi.
2. Strukturat përgjegjëse sigurojnë që informacioni i shkëmbyer të jetë i nevojshëm, proporcional, i saktë dhe i mbrojtur nga akseset e paautorizuara.
3. Çdo strukturë që administron ose përpunon të dhëna në kuadër të këtij vendimi është përgjegjëse për saktësinë, plotësinë, përditësimin dhe ruajtjen e tyre.

Neni 26 **Raportimi periodik dhe analiza**

1. Strukturat vendore përgatisin raporte periodike mbi monitorimin e situatës së fëmijëve, familjeve kujdestare dhe ofruesve të shërbimit, sipas afateve dhe formateve të përcaktuara nga ministria përgjegjëse.
2. Shërbimi Social Shtetëror përgatit raporte tremujore dhe gjashtëmujore të konsoliduara, ku pasqyrohen të dhënat kryesore, problematikat, trendet, masat e ndërmarra dhe rekomandimet për përmirësimin e shërbimit.
3. Ministria përgjegjëse përdor raportet për planifikimin e politikave, buxhetimin, përmirësimin e standardeve, forcimin e kapaciteteve dhe vlerësimin e funksionimit të sistemit të kujdesit alternativ në familje.

Neni 27

Trajtimi i ankesave dhe sinjalizimeve

1. Kur gjatë monitorimit ose inspektimit evidentohen ankesa, sinjalizime ose informacione që lidhen me cenimin e sigurisë, mirëqenies, zhvillimit ose të drejtave të fëmijës, struktura përgjegjëse i dokumenton dhe i referon menjëherë pranë strukturave kompetente.
2. Paraqitja e ankesës ose sinjalizimit nuk pezullon marrjen e masave të menjëhershme mbrojtëse, kur nga rrethanat rezulton se fëmija ndodhet në rrezik ose se interesi i tij më i lartë mund të cenohet.
3. Ankesat dhe sinjalizimet që lidhen me situatën e fëmijës, familjen kujdestare ose ofrimin e shërbimit trajtohen sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor të posaçëm për trajtimin e ankesave

Neni 28

Ngarkimi për zbatim

Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi ministria përgjegjëse për çështjet sociale, Shërbimi Social Shtetëror, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, njësitë e vetëqeverisjes vendore, strukturat përgjegjëse të mbrojtjes së fëmijës, strukturat inspektuese dhe organizatave të shoqërisë civile, mbështetës të shërbimit të kujdesit alternativ në familje.

Neni 29

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA